



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

KOMISIONI I PROVIMEVE TË AFTËSIVE PROFESIONALE

24.06.2023

*“PROCEDURAT E PUNËS PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE,
SIPAS KËRKESAVE TË STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË AUDITIMIT”*

ALTERNATIVA (12 x 1 pikë)

1. Në bazë të Ligjit 10091 ‘Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar’, auditim ligjor është:
 - a) një auditim i pavarur i pasqyrave financiare vjetore individuale;
 - b) një auditim i pavarur i pasqyrave financiare vjetore të konsoliduara;
 - c) një auditim që kërkohet nga ligji 10091 “Për Auditimin Ligjor” sipërmendur;
 - d) një auditim që kërkohet nga ligje të tjera;
 - e) një auditim që kryhet në mënyrë vullnetare kur zbatohen standarde dhe kërkesa të legjislativës, të barasvlershme me ato që kërkohen për një auditim ligjor,
 - f) Të gjitha të mësipërmet;
 - g) Vetëm a), b) dhe c);
 - h) Asnjëra.

Përgjigja e saktë është pika f.

2. “Standardet ndërkombëtare të auditimit” janë standardet e miratuara dhe të publikuara nga:
 - a) Bordi i Mbiqëqyrjes Publike;
 - b) Instituti i Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar;
 - c) Keshilli Kombëtar i Kontabilitetit;
 - d) Ministri i Financave dhe Ekonomisë;
 - e) Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve;
 - f) Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë;
 - g) Vetëm a) dhe b);
 - h) Vetëm a), b), dhe e).

Përgjigja e saktë është pika f.

3. Në bazë të Kodit të Etikës të IEKAs kur një audituesi ligjor i janë besuar paratë (apo aktivet e tjera) që ju përkasin të tjerëve cilat janë masat mbrojtëse që duhet të ndermarren kundrejt kërcënimeve të egoizmit ndaj sjelljes profesionale dhe/ose objektivitetit:
 - a) T’i mbajë këto aktive veças aktiveve të tij personale, apo të firmës së auditimit;

- b) Ti raportojë ato në bazë vjetore pranë Administratës Tatimore;
- c) Të përdorë këto aktive vetëm për qëllimet, për të cilat ato janë parashikuar;
- d) Gjatë gjithë kohës, të jetë në gjendje të japë llogari për këto aktive, për të ardhurat dhe dividendët, apo të ardhura të tjera të gjeneruara, për çdo person që ka të drejtë ndaj tyre;
- e) Të respektojë të gjitha ligjet dhe rregullat përkatëse për mbajtjen dhe kontabilizimin e këtyre aktiveve;
- f) Ti raportojë ato në mënyrë periodike pranë Bordit të Mbikqyrjes dhe IEKAs;
- g) Vetëm a), b), c) dhe e);
- h) Vetëm a), c), d) dhe e).

Përgjigja e saktë është pika h.

4. Në bazë të Ligjit 10091 'Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar', audituesi ligjor ose shoqëria audituese, që kryen auditimin ligjor të njësisë ekonomike me interes publik, ka detyrimin:

- a) paraqet çdo vit pranë komitetit të auditimit shërbimet e tjera shtesë, që i ka ofruar subjektit të audituar;
- b) monitoron proceset e raportimit financiar;
- c) diskuton me komitetin e auditimit mbi kërcënimet për pavarësinë dhe masat mbrojtëse të sigurisë, të marra kundrejt tyre;
- d) konfirmon çdo vit pavarësinë e vet nga subjekti i audituar;
- e) monitoron efektshmërinë e kontrollit të brendshëm të entitetit, auditimin e brendshëm;
- f) Të gjitha të mësipërmet;
- g) Vetëm a), c) dhe d);
- h) Vetëm a), c), d) dhe e).

Përgjigja e saktë është pika g.

5. Në rastin e auditimit ligjor të pasqyrave financiare të konsoliduara të një grupi sipërmarrjesh, audituesi ligjor i grupit:

- a) mban përgjegjësi të plotë për auditimin e pasqyrave financiare të konsoliduara dhe raportin e auditimit;
- b) nuk kryen kontroll të auditimit, të bërë nga audituesit ligjorë të tjerë, si edhe në një juridiksion tjetër, për qëllimet e auditimit të grupit.
- c) mban përgjegjësi të plotë për auditimin e pasqyrave financiare të konsoliduara dhe raportin e auditimit, por jo për pasqyrat individuale të degëve të grupit
- d) nuk mban përgjegjësi për auditimin e pasqyrave financiare individuale dhe të raportit të auditimit;
- e) të gjitha të mësipërmet
- f) vetëm a) dhe c)
- g) vetëm a), c), dhe d)
- h) asnjë nga të mësipërmet.

Përgjigja e saktë është pika g.

6. Perfshirja e një paragrafi “te theksimit të çështjes” në një raport auditimi, kur audituesi nuk ka zbuluar anomali materiale dhe as te përhapura dhe kur te gjitha kushtet e tjera supozohen te pandryshuara, bën që raporti të karakterizohet si?
- Raport me opinion me rezerve
 - Raport me opinion të pamodifikuar
 - Raport me opinion të kundërt
 - Raport me refuzim dhënie opinionit
 - Raport me paragraf “çështje te tjera”
 - Raport me paragraf “Informacione te tjera”
 - Alternativa e) dhe f) jane te sakta
 - Asnje nga alternativat me lart.

Përgjigja e saktë është pika b.

7. Sipas SNA 710, “Informacionet Krahasuese – Shifrat Korresponduese dhe Pasqyrat Financiare Krahasuese” ekzistojnë dy metoda të ndryshme, që përdoren gjerësisht, të cilat trajtojnë përgjegjësitë e raportimit të audituesit në lidhje me këto informacione krahasuese: shifrat korresponduese dhe pasqyrat financiare krahasuese. Cila prej alternativave te mëposhtme sqaron diferencat thelbësore të raportit të auditimit ndërmjet dy metodave?
- Për shifrat korresponduese, opinionit i audituesit mbi pasqyrat financiare i referohet vetëm periudhës aktuale
 - Për pasqyrat financiare krahasuese, opinionit i audituesit i referohet secilës periudhë për të cilën janë paraqitur pasqyrat financiare.
 - Për shifrat krahasuese, opinionit i audituesit mbi pasqyrat financiare i referohet vetëm periudhës aktuale
 - Për shifrat korresponduese, opinionit i audituesit mbi pasqyrat financiare i referohet vetëm periudhës se ardhshme e cila nuk ka ndodhur akoma;
 - Alternativa a) edhe b) jane te sakta;
 - Alternativa b) dhe c) jane te sakta;
 - Alternativa c) dhe d) jane te sakta;
 - Alternativa a); b), c) dhe d) jane te sakta;

Përgjigja e saktë është pika e.

8. Audituesi identifikoi gjate procesit te auditimit te te ardhurave te nje Shoqerie, se ne pasqyrat financiare te Shoqerise, te ardhurat nuk ishin njohur, matur dhe prezantuar me shënime shpjeguese sipas SNRF 15 “Te ardhurat nga kontratat me klientet”. Nga shqyrtimi i materialitetit te kësaj shmangie nga standardet kontabël dhe aspekteve te tjera cilesore, si edhe si rezultat i evidencës se mjaftueshme e te përshtatshme te dokumentuar, anomalia u identifikua dhe u konsiderua materiale por edhe e përhapur, opsionet e raportimit të audituesit ligjor ishin?
- Opinion i pamodifikuar
 - Opinion me rezerve
 - Refuzim dhënie opinionit
 - Opinion i pamodifikuar me paragraf “theksim çështje”
 - Opinion i pamodifikuar me paragraf “çështje te tjera”
 - Te gjitha me lart
 - Asnje nga alternativat me lart
 - Opinion i kundërt

Përgjigja e saktë është pika h.

9. Në cilat kushte Eksperti duhet të tërhiqet nga angazhimi i rishikimit, bazuar ne Standardin Ndërkombëtar të Angazhimeve të Rishikimit 2400?
- Për shkak të një kufizimi të fushës së rishikimit të vendosur nga Drejtimi pasi Eksperti ka pranuar angazhimin, dhe nuk është në gjendje të marrë prova të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të formuar një konkluzion mbi pasqyrat financiare
 - Eksperti ka përcaktuar se efektet e mundshme të anomalive të pazbuluara në pasqyrat financiare janë materiale dhe të përhapura
 - Eksperti ka përcaktuar se efektet e anomalive të zbuluara në pasqyrat financiare janë materiale dhe të përhapura
 - Tërheqja është e mundur sipas ligjit ose rregullores në fuqi
 - Të gjithë alternativat e mësipërme
 - a), b), c)
 - a), b), d)
 - b), c), d)

Përgjigja e saktë është pika g.

10. Në një rishikim të pasqyrave financiare, kryerja e procedurave analitike ndihmon Ekspertin në:
- Marrjen ose përditësimin e kuptueshmërisë për njësinë ekonomike dhe mjedisin e saj, duke përfshirë aftësinë për të identifikuar fushat ku ka gjasa të shfaqen anomali materiale në pasqyrat financiare
 - Identifikimin e mospërputhjeve ose variacioneve nga tendencat, vlerat ose normat e pritura në pasqyrat financiare
 - Sigurimin e evidencave në lidhje me procedurat e tjera hetimore ose analitike të kryera tashmë
 - Procedura shtesë kur Eksperti vihet në dijeni për çështje që e bëjnë që të besojë se pasqyrat financiare mund të përmbajne anomali materiale.
 - Të gjithë alternativat e mësipërme
 - a), b), c)
 - a), b), d)
 - b), c), d)

Përgjigja e saktë është pika e.

11. Cilat janë disa prej procedurave që mund të aplikohen në një angazhim të procedurave të rena dakort:
- Hetime dhe analiza;
 - Rillogaritje, krahasime dhe verifikime saktësie të tjera;
 - Observime;
 - Inspektime;
 - Marrja e konfirmimeve;
 - Të gjithë alternativat e mësipërme;
 - a dhe e;
 - a, d, dhe e;

Përgjigja e saktë është pika f.

12. Ku ndryshon kuadri i shërbimeve të lidhura (p.sh SNSL 4400) nga kuadri i dhenies së sigurisë:
- a. Angazhimi i Shërbimeve të Lidhura nuk rezultojnë në dhenien e një opinion;
 - b. Shërbimet e lidhura përmirësojnë nivelin e konfidencës që mund të kenë përdoruesit e raporteve;
 - c. Shërbimet e lidhura japin pajtueshmeri me SNAS;
 - d. Shërbimet e lidhura japin pajtueshmeri me SNA;
 - e. Të gjithë alternativat e mësipërme;
 - i. a dhe b;
 - j. a, b, dhe c;
 - k. Asnjëra nga më sipër.

Përgjigja e saktë është pika a.

PYETJE ME SHTJELLIM (5 pikë secila pyetje)

1. Listoni kriteret dhe kushtet që duhet të plotësohen në mënyrë që shoqëritë shtetërore ose private, të cilat janë të rëndësishme për interesin e publikut, për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre, të konsiderohen njësi me interes publik.

Përgjigje:

Shoqëritë shtetërore ose private, të cilat janë të rëndësishme për interesin e publikut, për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre, konsiderohen njësi me interes publik në rastet kur, **njëkohësisht**, plotësohen:

- kushtet e detyrimit të auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të përcaktuara në nenin 41, të ligjit nr. 10091
 - si dhe kriteret e parashikuara në VKM 17 dt. 16.01.2019 e njëjës prej pikave të mëposhtme: (0.5 pikë)
- **Klasifikimi për shkak të natyrës së biznesit**
- a) Shoqëri ku shteti ka pjesëmarrje në kapital; (0.5 pikë)
 - b) Shoqëri që kanë më shumë se 50% të të ardhurave nga fondet publike; (0.5 pikë)
 - c) Shoqëri që operojnë si degë, shoqëria mëmë e të cilave është e listuar në bursë; (0.5 pikë)
 - ç) Shoqëri të cilat ofrojnë një të mirë publike në aktivitetin e tyre tregtar dhe janë subjekt i rregullatorëve të fushës përkatëse. (0.5 pikë)
- **Klasifikimi për shkak të madhësisë së biznesit**
- a) Shoqëri që vlerën e totalit të të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël e kanë të barabartë ose më të madhe se 1 500 000 000 (një miliard e pesëqind milionë) lekë; (0.5 pikë)
 - b) Shoqëri që vlerën e totalit të aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël e kanë të barabartë ose më të madhe se 750 000 000 (shtatëqind e pesëdhjetë milionë) lekë; (0.5 pikë)
 - c) Kur në datën e raportimit një shoqëri i tejkalon ose bie nën kufirin e kriterëve të parashikuara në shkronjat “a” dhe “b”, të kësaj pike, cenohet klasifikimi, vetëm nëse kjo ndodh për dy periudha raportuese radhazi. (0.5 pikë)
- **Klasifikimi për shkak të numrit të punëmarrësve të tyre**
- a) Shoqëri që, në fund të periudhës kontabël, **kanë më shumë se 250** (dyqind e pesëdhjetë) punonjës; (0.5 pikë)
 - b) Shoqëri që, për gjithë periudhën kontabël, **kanë një numër mesatar punonjësish prej më shumë se 250** (dyqind e pesëdhjetë). (0.5 pikë).
2. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese, gjatë kryerjes së auditimit, duhet të jenë të pavarur nga personi juridik që auditohet dhe nuk duhet të marrin pjesë në vendimmarrjen e këtij entiteti. Në bazë të ligjit 10091 “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar”, si vepron audituesi në raste të cenimit të pavarësisë prej konflikteve të interesit?

Përgjigje:

Neni 33 i Ligjit 10091 përcakton situata e konfliktit të interesit të një audituesi ligjor dhe masat që do duhet të marrë:

1. Nëse pavarësia e audituesit ligjor ose shoqërisë audituese cenohet nga kërcënime apo presione, që lidhen me konflikte të interesit, siç është interesi personal, familjariteti, frikësimi apo mosbesimi, audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet të marrë masa mbrojtëse, me qëllim që të pakësojë ose të eliminojë efektin e këtyre rrethanave në kryerjen e auditimit. (1 pikë).
 2. Nëse shkalla e kërcënimeve, në krahasim me masat mbrojtëse, është e tillë, që të rrezikohet pavarësia, audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet të heqë dorë nga auditimi ligjor. (1 pikë).
 3. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese nuk duhet ta kryejnë auditimin nëse ekziston ndonjë lidhje, e drejtpërdrejtë ose e tërthortë, financiare, biznesi ose punësimi ndërmjet audituesit ligjor, shoqërisë audituese, apo rrjetit të audituesve dhe personit juridik që auditohet, kur kjo lidhje shkel pavarësinë e audituesit ligjor ose të shoqërisë audituese. (1 pikë)
 4. Audituesi ligjor dhe shoqëria e auditimit, krahas auditimit ligjor, mund të kryejnë edhe shërbimet e kontabilitetit, shërbimet e rishikimit e të dhënies së sigurisë ose shërbime të tjera, sipas përcaktimeve të bëra për to në standardet dhe deklaratat e IAASB-së, kur ato janë në pajtim me natyrën e profesionit dhe me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Në të gjitha këto raste duhet të zbatohen dispozitat e këtij ligji për ruajtjen e pavarësisë dhe shmangien e konfliktit të interesit. (1 pikë)
 5. Organizata profesionale e audituesve ligjorë siguron që audituesit ligjorë ose shoqëritë audituese dokumentojnë në fletët e tyre të punës së auditimit të gjitha kërcënimet/presionet e konsiderueshme, që lidhen me pavarësinë e tyre, si dhe masat e marra për shmangien e tyre. (0.5 pikë)
 6. Tarifa e auditimit ligjor nuk duhet të jetë influencuar apo përcaktuar në funksion të kryerjes së shërbimeve të tjera për njësinë ekonomike të audituar dhe nuk mund të jetë bazuar në ndonjë formë tjetër kushtëzimi. (0.5 pikë)
3. SNA 620 Përdorimi i punës së një eksperti shpjegon se si një auditues mund të përdorë një ekspert për të marrë evidence auditimi. Shpjegoni tre faktorë që audituesi i jashtëm duhet të marrë parasysh kur vlerëson kompetencën e ekspertit.

Përgjigje:

Ashtu si është e parashikuar në paragrafet A14-20 të SNA 620, Tre nga faktorët që audituesi i jashtëm duhet të marrë parasysh kur vlerëson kompetencën e ekspertit

1. Kualifikimi profesional i ekspertit. Eksperti në mënyrë ideale duhet të jetë anëtar i një organi përkatës profesional ose të ketë licencën e nevojshme për kryerjen e punës (2 pike).
2. Përvoja dhe reputacioni i ekspertit në fushën në të cilën auditori kërkon evidence auditimi (1.5 pike).
3. Pavarësia e ekspertit nga kompania kliente. Eksperti nuk duhet të punësohet e as të jete i punësuar nga klienti (1.5 pike).

Paragrafet A14-20 parashikojnë edhe faktore të tjera që duhet të merren parasysh kur vlerësohet kompetenca e ekspertit dhe punës së tij.

4. Cili është objekti i standardit ndërkombëtar të auditimit 805” Konsiderata të Veçanta – Auditimet e Pasqyrave Financiare të Vetme dhe Elementëve, Llogarive ose Zërave të Veçantë të një Pasqyre Financiare”? Listo tre shembuj të elementeve, llogarive ose zërave të vecante të një pasqyre, për të cilat përdoret ky standard.

Përgjigje:

Objekti i SNA 805 ” Konsiderata të Veçanta – Auditimet e Pasqyrave Financiare të Vetme dhe Elementëve, Llogarive ose Zërave të Veçantë të një Pasqyre Financiare”. trajton konsiderata të veçanta në zbatimin e këtyre SNA-ve në auditimin e një pasqyre financiare të vetme, ose elementëve, llogarive ose të zërave të veçantë të një pasqyre financiare. Një pasqyrë financiare e vetme, ose elementi, llogaria apo zëri i veçantë i një pasqyre financiare mund të përgatitet në përputhje me një kuadër për qëllime të përgjithshme ose për qëllime të veçanta. Nëse është përgatitur në përputhje me një kuadër për qëllime të veçanta, përsëri për auditimin do të zbatohet SNA 800 (i rishikuar). (1 pike).

Ky standard nuk zbatohet për raportin e audituesit të një komponenti (entiteti të kontrolluar), të lëshuar si rezultat i punës së bërë mbi informacionin financiar të një komponenti, me kërkesë të grupit të angazhimit të grupit të entiteteve të kontrolluara për qëllime të një auditimi të pasqyrave financiare të grupit. (0.5 pike) Ky SNA nuk i tejkalon kërkesat e SNA-ve të tjera; dhe as nuk ka për qëllim të merret me të gjithë konsideratat e veçanta, të cilat mund të jenë të rëndësishme në rrethanat e angazhimit. (0.5 pike)

Shembuj të elementeve, llogarive ose zërave të vecante të një pasqyre, për të cilat përdoret ky standard do të ishin si më poshtë?

1. Llogaritë e arkëtueshme, provizionet për llogari të arkëtueshme të dyshimta, inventarët, detyrimi për përfitimet e llogaritura të një skeme private të pensioneve, vlera e regjistruar e aktiveve jomateriale të identifikuar, ose detyrimi për pretendimet “e ndodhura por jo të regjistruara” në një portofol të sigurimeve, përfshirë shënimet shpjeguese. (1 pike).
2. Një tabelë e aktiveve të menaxhuara nga jashtë (nga të tretë) dhe të ardhurat e një skeme private të pensioneve, përfshirë shënimet shpjeguese. (1 pike).
3. Një tabelë e aktiveve materiale neto, përfshirë shënimet shpjeguese. (1 pike).
4. Një tabelë e pagesave në lidhje me një aktiv të dhënë me qira, përfshirë shënimet shpjeguese.
5. Një tabelë e pjesëmarrjes në fitim ose e shpërblimit të punonjësve, përfshirë shënimet shpjeguese.

Shenim: Nëse janë dhënë shembuj të tjerë të cilët lidhen me elemente të pasqyrave financiare nga ana e kandidatit dhe të cilat nuk gjenden më lart, serish, përgjigja do të konsiderohet korrekte dhe çdo shembull i dhënë do të vlerësohet me 1 pike. Lista e shembujve më lart është dhënë me shume se TRE për të treguar diapazonin e gjere të shembujve/përgjigjeve. Çdo shembull vlerësohet me 1 pike.

5. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese i nënshtrohet një sistemi kontrolli, që ka për qëllim dhënien e sigurisë për cilësinë e punës audituese. Duke u bazuar në ligjin 10091 “ Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratur “ shpjegoni procedurën e kontrollit të cilësisë.

Përgjigje:

Neni 39 i Ligjit 10091 parashikon procedurën e përzgjedhjes së kontrollit të cilësisë të audituesve ligjorë ose shoqërisë audituese si më poshtë:

1. Përzgjedhja e personave për kontrollin e cilësisë bëhet në bazë të një procedure objektive, e cila jep garanci se nuk ka konflikt interesash ndërmjet kontrollorit dhe audituesit ligjor ose shoqërisë audituese që kontrollohet. (0.5 pikë)
2. Kontrolli i cilësisë realizohet përmes kontrollit të dosjeve të përzgjedhura të auditimit dhe përfshin një vlerësim të përputhshmërisë me standardet e zbatueshme të auditimit dhe kërkesat e etikës e pavarësisë, të cilësisë dhe sasisë së burimeve të shpenzuara, të tarifave të auditimit të ngarkuara dhe një vlerësim të sistemit të brendshëm të kontrollit të cilësisë të shoqërisë audituese. (1 pikë)
3. Kontrolli i cilësisë shoqërohet me përgatitjen e një raporti nga kontrolluesi, që përmban konkluzionet kryesore të kontrollit të kryer. Ky raport i paraqitet komitetit të kontrollit të cilësisë. Në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet kontrolluesit dhe të kontrolluarit, arbitrimi bëhet nga komisioni i kontrollit të cilësisë, pasi audituesi ligjor i kontrolluar ka paraqitur, formalisht, qëndrimet e tij. (1 pikë)
4. Kontrolli i cilësisë kryhet në bazë të një analize risku, të paktën një herë në çdo tre vjet, për audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit që auditojnë njësitë ekonomike me interes publik, dhe një herë në çdo gjashtë vjet, për audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit që auditojnë njësitë e tjera ekonomike. Për audituesit ligjorë, me jo më shumë se pesë vjet përvojë pune në profesion, ky kontroll kryhet, të paktën, një herë në dy vjet, derisa arrihet eksperiencia e kërkuar. (1 pikë)
5. Organizata profesionale e audituesve ligjorë raporton çdo vit, pranë Bordit të Mbikëqyrjes Publike, për rezultatet e sistemit të kontrollit të cilësisë për auditimet e njësisve ekonomike që nuk janë me interes publik, në rastet kur ia ka deleguar bordi. Rezultatet e përgjithshme të sistemit të kontrollit të cilësisë publikohen çdo vit nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike. (1 pikë)
6. Rekomandimet e dhëna në përfundim të procesit të kontrollit të cilësisë duhet të ndiqen për t'u zbatuar nga audituesi ligjor ose shoqëria e auditimit, brenda një periudhe kohe të arsyeshme. (0.5 pikë)

6. Cfare përmban kufizimi ne shpërndarje ose ne përdorim ne nje raport audituesi? Cili standard auditimi e mbulon trajtimin e tij?

Përgjigje:

Sipas SNA 800 (i rishikuar) “KONSIDERATA TË VEÇANTA—AUDITIMET E PASQYRAVE FINANCIARE TË PËRGATITURA NË PËRPUTHJE ME KUADROT PËR QËLLIME TË VEÇANTA “ paragrafi. A21 (1 pike), përveç paralajmërimit të kërkuar nga paragrafi 14, audituesi mund të konsiderojë të përshtatshme të tregojë se raporti i audituesit është parashikuar vetëm për përdorues specifikë. (1 pike). Në varësi të ligjit ose rregullave të një juridiksioni të veçantë, kjo mund të arrihet duke kufizuar shpërndarjen ose përdorimin e raportit të audituesit (1 pike). Fjalja që do të përmendet në raportin e auditimit do jete si vijon: “Raporti ynë ka për qëllim vetëm Shoqërinë dhe përdoruesit xxx dhe nuk duhet të shpërndahet apo të përdoret nga palët përveç këtyre të përmenduar me lart. (1 pike). Përdorimi i kufizimit të shpërndarjes tipikisht mund të zgjerohet brenda paragrafit të theksimit të çështjes se një raport i auditimi i cili paralajmëron përdoruesit e informacionit financiar që informacioni financiar është përgatitur mbi një bazë kontabël specifike, informacioni financiar shërben për qëllime të veçanta, të tilla si ato të përgatitura në përputhje me kërkesat e një kontrate, një kuadër për qëllime të veçanta dhe, për këtë arsye, mund të mos jenë të përshtatshme për ndonjë qëllim tjetër. (1 pike).

7. SNA 510 Angazhimet fillestare të auditimit – balancat e celjes kërkon që audituesit të ndërmarrin procedura shtesë të auditimit për konfirmimin e balancave të celjes për angazhimet e reja të auditimit. Përveç kësaj, SNA jep udhëzime mbi implikimet ne raportin e audituesit nëse audituesit nuk janë në gjendje të konfirmojnë balancat e celjes ose nëse ato përmbajnë anomali. Përshkruani procedurat që audituesi duhet të ndërmarrë për të konfirmuar balancat e celjes për një angazhim të ri auditimi.

Përgjigje:

Një auditues duhet të marrë evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme nëse balancat e celjes përmbajnë anomali të cilat mund të ndikojnë materialisht në pasqyrat financiare të vitit aktual dhe nëse politikat kontabël zbatohen në mënyrë të qëndrueshme. Paragrafi 5 dhe 6 i SNA 410 parashikon që audituesi duhet të kryejë procedurat e mëposhtme:

1. Rishikoni pasqyrat financiare më të fundit, nëse ka, dhe raportin e audituesit të vitit të kaluar, nëse ka, për informacione të rëndësishme për balancat e celjes, duke përfshirë shënimet shpjeguese (1 pike).
 2. Audituesi duhet të rikoncilojë balancat e celjes së pasqyrave financiare aktuale me balancat e mbylljes të vitit të kaluar për të konfirmuar nëse ato janë sjellë saktë në vitin aktual (1 pike).
 3. Audituesit duhet të përcaktojnë nëse balancat e celjes reflektojnë zbatimin e politikave të përshtatshme kontabël (1 pike).
 4. Audituesit duhet të konsiderojnë rishikimin e fletëve të punës së audituesit të mëparshëm për të marrë evidenca në lidhje me balancat e celjes. Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë ata duhet të konsiderojnë nëse procedurat e kryera në periudhën aktuale ofrojnë evidencë mbi balancat e celjes (1 pike).
 5. Në raste të jashtëzakonshme, audituesit mund t'i duhet të kryejë procedura të veçanta auditimi për të marrë evidencë në lidhje me balancat e celjes (1 pike).
-
8. Standartet Nderkombetare të Angazhimeve të Rishikimit (SNAR) janë të aplikueshme dhe adaptohen sipas nevojës për qëllime të rishikimit të informacioneve financiare historike. Diskutoni dhe shtjelloni ngjashmeritë dhe diferencat midis SNAR 2400 dhe SNAR 2410 si dhe ngjashmeritë dhe diferencat të procedurave që duhet kryhen dhe të aplikoheni në secilin nga angazhimet.

Përgjigje:

SNAR 2400 janë të aplikueshme për ato auditues ligjor të cilin angazhohen për të kryer një rishikim të informacioneve financiare historike kur auditues ligjor nuk është auditor i pasqyrave financiare të entitetit ndërsa SNAR 2410 janë të aplikueshme për ato auditues ligjor të cilin ndërmarrin një angazhim rishikimi të pasqyrave financiare të ndërmjetme për ato klient që janë edhe klient auditimi (2 pike).

Nëpërmjet kryerjes të auditimit të pasqyrave financiare vjetore, audituesi ligjor merr një kuptim të entitetit dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të saj të cilin e perdor kur është i angazhuar për të rishikuar pasqyrat financiare të ndermjetme sipas SNAR 2410 (2 pike).

Ky informacion i marre gjate procesit të auditimit të pasqyrave financiare vjetore përditësohet nëpërmjet procedurave të bëra gjatë rishikimit dhe ndihmon auditorin në fokusimin e procedurave analitike dhe të tjera të rishikimit që do të zbatohen gjate aplikimit të SNAR 2410. Nderkohe ne nje angazhim sipas SNAR 2400 audituesi ligjor eshte i detyruar te kryeje procedurat e plota dhe me vete per te marr një kuptim të entitetit dhe mjedisit të tij, duke përfshirë edhe testimin e kontrollin e brendshëm si procedura shtese nga ato te parashikuara ne SNAR 2410 (1 pike).

USHTRIME (6 pikë secila)

Ushtrimi 1

Shoqëria Pipa SH.A. ka një rrjet prej 20 dyqanesh të cilat i ka marrë me qira me afate që përfundojnë nga 2 deri në 7 vitet e ardhshme. Dyqanet nuk mund të shiten dhe as të ri-jepen me nën-qira nga shoqëria. Kontrata e qirasë për zyrat qendrore të shoqërisë përfundon pas tre vitesh.

Për të shitur pajisjet elektronike, shoqëria shfrytëzon edhe një rrjet distributorësh. Pajisjet i shiten distributorëve në momentin që ata kanë nevojë për inventar. Megjithatë, distributorët nuk e shlyejnë faturën deri në momentin e shitjes tek klienti fundor. Gjithashtu, distributorët mbajnë një përqindje të caktuar nga çmimi i shitjes për defekte të mundshme të pajisjeve të shitura që mund të kërkojnë riparime.

Shoqëria i përgatit pasqyrat financiare sipas SNRF.

Kërkohet: Tregoni procedurat e nevojshme të auditimit për të adresuar pohimet përkatëse në lidhje me gjendjet në pasqyrën e pozicionit financiar të shoqërisë për:

- a) Llogaritë e arkëtueshme nga distributorët
- b) Detyrimet e qirasë

Pergjigje:

- a. Procedurat e nevojshme për të adresuar pohimet përkatëse për Llogaritë e arkëtueshme nga distributorët: (3 pike si me poshte)
 - Rakordimi i gjendjes së llogarive të arkëtueshme sipas distributorëve kundrejt arkëtimit përkatëse pas datës së raportimit (mbledhja e llogarive të arkëtueshme pas datës së raportimit) (0.5 pike)
 - Për ato shuma që mbeten të pa-shlyera ende pas datës së raportimit, diskutim me drejtimin dhe inspektim të korrespondencave me distributorët për mos-marrëveshje të mundshme; (0.5 pike)
 - Analizë e marrëveshjeve me distributorët për të parë nëse ka shkelje të marrëveshjes nga ana e shoqërisë që mund të rezultojë në penalitete të mundshme (detyrim të pa-njohur në pasqyrat financiare) (0.5 pike)
 - Rakordim i gjendjes kundrejt faturave dhe kontratave për saktësim të vlerës; (0.5 pike)

Vini re që konfirmimi i llogarisë në këtë rast nuk është metoda më e përshtatshme pasi në këtë rast rreziku kryesor është vjetërsia e llogarisë së arkëtueshme, mungesa e provizionimit si dhe nën-vlerësimi i detyrimeve. (1 pike)
- b. Procedurat e nevojshme për të adresuar pohimet përkatëse për Detyrimet e qirasë: (3 pike si me poshte)
 - Inspektimi i marrëveshjeve të qirasë për të vërtetuar detyrimet e qirasë, datat e fillimit dhe të mbarimit të kontratës së qirasë, dhe të dhënat nëse marrëveshje mund të mbyllet ose jo para afatit; (0.5 pike)
 - Inspektim i korrespondencës me qiradhënësit për ndonjë marrëveshje të mundshme për shtyrje të afatit të qirasë apo mbyllje para afatit, gjë e cila sjell ndryshime në flukset e parashkuara të qirasë që aktualizohen për të njohur detyrimin e qirasë në bilanc; (0.5 pike)

- Rishikim i planeve të bizensit të shoqërisë në lidhje me dyqanet e saj për të parë nëse planet për shfrytëzim të dyqanit me qira përputhen me afatet e qirasë të parashikuara në përlogaritjet përkatëse të detyrimit të qirasë; (0.5 pike)
- Analizë e normave të përdorura të aktualizimit për përshtatshmëri kundrejt kërkesave të SNRF; (0.5 pike)
- Rillogaritje e detyrimit të qirasë në fund të vitit dhe shpenzimeve përkatëse të interesit; (0.5 pike)
- Analizë dhe rakordim e shpalosjeve përkatëse që kërkohen nga SNRF në lidhje me qiranë në pasqyrat financiare; (0.5 pike)

Ushtrimi 2

Shoqëria Nafta Sh.a., ka një licencë për të eksploruar, nxjerrë dhe eksportuar më pas burime të mundshme të naftës në veri të vendit. Licenca i është dhënë nga AKBN pa kosto shtesë. Megjithatë, Nafta Sh.a.e ka njohur licencën me vlerën e drejtë të supozuar prej 100,000,000 Lekësh. Aktivet afatgjata materiale përfshijnë 5 platforma të nxjerrjes së naftës. Platformat përbëhen nga shumë elementë të ndryshëm. Jeta e mbetur e dobishme duhet të rishikohet në çdo datë raportimit. Amortizimi llogaritet me metodën lineare përgjatë 15-40 viteve.

Kërkohet: Identifikoni rreziqet e auditimit si dhe procedurat e auditimit për të kryer në lidhje me jetët e dobishme të platformave të nxjerrjes së naftës.

Pergjigje:

-Identifikimi i rreziqeve te auditimit: (3 pike si me poshte)

- Shoqërisë i duhet licencë për të kryer aktivitetin. Në rast të humbjes së licencës (p.sh. Si pasojë e mos-përmbushjes së kërkesave ligjore të AKBN) shoqëria mund të rrezikojë të mos përmbushë parimin e vijimësisë. (0.75 pike)
- Licenca mbahet me vlerë të drejtë dhe jo me kosto. Është e nevojshme të analizohen kërkesat e standardeve për këtë trajtim, si dhe, në rast se lejohet, të gjendet evidenca se ku bazohet vlera 100 milionë Lekë për sa kohë licenca është dhënë pa kosto shtesë nga AKBN. (0.75 pike)
- Shoqëria përdor një larmishmëri jetësh së dobishme për aktivet e saj, gjë e cila është e kuptueshme nëse marrim parasysh larmishmërinë e aktiveve që ajo përdor për të kryer aktivitetin e saj. Megjithatë, ekziston një rrezik që aktivet të klasifikohen gabimisht në jetë të ndryshme të dobishme nga ajo e tyre dhe rrjedhimisht përlogaritje e gabuar e amortizimit (që mund të sjellë edhe mos-përmbushje të kërkesave rregullatore). (0.75 pike)
- Në industrinë e eksplorimit të burimeve natyrore, detyrimet për sjelljen në gjendjen e mëparshme në fund të licencës (sidomos për ato platforma që nuk janë patur sukses), janë të zakonshme ndërkohë që nuk përmenden në ushtrim. Është një çështje për t'u trajtuar pasi kemi një rrezik për nën-vlerësim të detyrimeve dhe aktiveve sipas SNK 37. (0.75 pike)

-Në lidhje me jetët e dobishme të platformave të nxjerrjes së naftës, shoqëria e auditimit mund të kryejë procedurat e mëposhtme: (3 pike si me poshte)

- Të krahasojë metodat e vlerësimit të jetëve të dobishme me ato të përdorura nga industria globale e nxjerrjes së naftës pasi zakonisht ekzistojnë disa standarde; në këtë mënyrë

audituesi merr evidencë për arsyeshmërinë e metodës si dhe të normave/viteve të jetës së dobishme; (0.5 pike)

- Të analizojë historikun e platformave të naftës që nuk përdoren më nga shoqëria për të parë nëse vlerësimet e jetës së dobishme përputhen me performancën aktuale; (0.5 pike)
- Për çdo platformë, të analizohet përlllogaritja e jetës së dobishme në bazë të parashikimeve për rezervat përkatëse të naftës (mund të kërkojë përfshirje të ekspertit përkatës së audituesit apo drejtimit); (0.5 pike)
- Inspektim fizik për një përziejdhje platformash për të verifikuar ekzistencën dhe përdorimin (mund të kërkohej edhe përfshirja e ekspertit përkatës së audituesit apo të drejtimit); (0.5 pike)
- Të kërkojë përfshirje në deklaratat më shkrim të drejtimit të konfirmimit që jeta ekonomike e platformave të naftës është e bazuar në vlerësimet e tyre më të mira (dhe detaje të tjera sipas rastit). Të lexojë proces-verbalet e mbledhjeve të bordit drejtues apo këshillit të mbikëqyrjes për diskutime të mundshme rreth jetëve të dobishme të platformave të naftës; (0.5 pike)
- Të marrë kopje të rishikimeve për zhvlerësim të kryera nga drejtimi përmes ekspertëve të vetë dhe të vlerësojë arsyeshmërinë e parashikimeve dhe supozimeve të përdorura; (0.5 pike)

Ushtrimi 3

Jackdaw Motor Cars Co (Jackdaw) prodhon një sërë makinash motorike dhe fundi i vitit të saj është 31 janar 2020. Ju jeni manaxheri i auditimit të Puffin & Co dhe aktualisht po përgatitni programet e auditimit për auditimin e fundvitit të Jackdaw. Ju keni pasur një takim me ekipin tuaj të auditimit dhe ai ju ka njoftuar për një sërë çështjesh të identifikuara gjatë procesit të vlerësimit të rrezikut të auditimit.

Toka dhe ndërtesat

Jackdaw kanë një politikë të rivlerësimit të tokës dhe ndërtesave, kjo është ndërmarrë në mënyrë të vazhdueshme gjatë një periudhe pesëvjeçare.

Gjatë vitit Jackdaw kërkoi nga një vlerësues i jashtëm që të rivlerësonte një numër pronash, duke përfshirë një magazinë të blerë në maj 2019. Amortizimi ngarkohet në mënyrë proporcionale.

Prodhimi në proces

Jackdaw ndërmerr prodhimin e vazhdueshëm të makinave, 24 orë në ditë, shtatë ditë në javë. Një numërim i inventarit do të kryhet në fund të vitit dhe Puffin & Co do të marrë pjesë. Ju jeni përgjegjës për auditimin e punës në vazhdim (WIP) dhe do të jeni pjesë e ekipit që ndjek numërimin, si dhe auditimin përfundimtar. WIP përfshin makinat pjesërisht të montuara në fund të vitit dhe kjo balance ka të ngjarë të jetë materiale. Jackdaw vlerëson WIP-in sipas përqindjes së përfundimit dhe kostot standarde aplikohen më pas në këto përqindje.

Kërkohet:

Përshkruani procedurat thelbësore që auditori duhet të kryejë për të marrë evidence të mjaftueshme dhe të përshtatshme auditimi në lidhje me:

- a) Rivlerësimi i tokës dhe ndërtesave dhe magazinës së blerë së fundmi; dhe
- b) Vlerësimi i prodhimit në proces.

Pergjigje:

Procedurat thelbësore për tokën dhe ndërtesat e rivlerësuara dhe magazinën e blerë së fundmi (3 pike ne total, cdo alternative e sakte 0.5 pike):

1. Merrni një skedul të të gjithë tokave dhe ndërtesave të rivlerësuara këtë vit për të konfirmuar plotësinë dhe saktësinë e rregullimit të rivlerësimit.
2. Në bazë të kampionit dakordësoni për shumat e rivlerësuara me dokumentin e vlerësimit të dhënë nga vlerësuesi.
3. Merrni parasysh kompetencën dhe aftësinë e vlerësuesit, duke vlerësuar përmes pyetjeve kualifikimin e tij, anëtarësimin në një organ profesional dhe përvojën në vlerësimin e këtyre llojeve të aktiveve.
4. Dakordësoni që shumat e rivlerësuara për këto pasuri të përfshihen saktë në regjistrin e aktiveve afatgjata.
5. Rillogaritni rregullimin total të rivlerësimit dhe dakordësoni që është regjistruar saktë në tepricën e rivlerësimit.
6. Dakordësoni për koston fillestare për shtesën e magazinës me dokumentacionin mbështetës, si p.sh. faturat për të konfirmuar koston.
7. Konfirmoni përmes një rishikimi të dokumenteve të pronësisë se magazina është në pronësi të Jackdaw.
8. Rillogaritni vlerën e amortizimit për vitin për të siguruar që për aktivet e rivlerësuara gjatë vitit, amortizimi është bazuar në vlerësimin e saktë dhe për shtesën e magazinës amortizimi ishte vetëm për nëntë muaj.
9. Rishikoni dhënien e shënimeve shpjeguese të pasqyrave financiare për rivlerësimin për t'u siguruar që ato janë në përputhje me SNK 16 Aktivet afatgjata materiale.

Procedurat thelbësore për prodhimin në proces (WIP) (3 pike ne total, cdo alternative e sakte 0.5 pike):

1. Përpara se të merrni pjesë në numërimin e inventarit, diskutoni me menaxhmentin se si përqindja e kompletimit i atribuohet WIP, për shembull, nëse kjo bazohet në makinat që kalojnë pika të caktuara në procesin e prodhimit.
2. Gjatë numërimit, vëzhgoni procedurat e kryera nga stafi i Jackdaw në vlerësimin e nivelit të WIP dhe merrni parasysh arsyeshmërinë e supozimeve të përdorura.
3. Bini dakord për një kampion që përqindja e përfundimeve të vlerësuara gjatë numërimit janë në përputhje me politikat e Jackdaw të komunikuar përpara numërimit.
4. Diskutoni me menaxhmentin bazën e kostove standarde të aplikuara për përqindjen e përfundimit të WIP-it dhe sa shpesh rishikohen dhe përditësohen këto.
5. Rishikoni nivelin e variancave ndërmjet kostove standarde dhe atyre aktuale dhe diskutoni me menaxhmentin se si trajtohen këto.
6. Merrni një ndarje të kostove standarde dhe dakordësoni një kampion të këtyre kostove me faturat aktuale ose të dhënat e listëpagesës për të vlerësuar arsyeshmërinë e kostove.
7. Merrni skedulën e WIP-it total dhe dakordësoni me bilancin verifikues dhe pasqyrat financiare.
8. Dakordësoni një kampion të WIP-it të vlerësuar gjatë numërimit me skedulën e WIP-it, dakordësoni se përqindja e kompletimit është e saktë dhe rillogaritni vlerësimin e inventarit.

Ushtrimi 4 Conglomerate shpk

Shoqeria Conglomerate shpk po përgatit pasqyrat financiare për vitin financiar të mbyllur më 31 dhjetor 2022. Paqyrat financiare duhet të përgatiten në përputhje me SNRF dhe Shoqeria nuk aplikon ndonjë ligj apo rregullore tjetër lokale. Paqyrat financiare përfshijnë: Pasqyrën e Pozicionit Financiar, Pasqyrën e fitim/humbjes dhe e të ardhurave gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe Pasqyrën e lëvizjes së flukseve të mjeteve monetare. Audituesit e jashtëm kërkohet që të raportojnë për aksionaret e Shoqerisë për vitin financiar të mbyllur më 31 dhjetor 2022. Conglomerate shpk ka disa filiale, një prej të cilëve (Shoqeria Bija shpk), e blerë gjatë vitit. Conglomerate shpk përgatit pasqyra financiare të konsoliduara, sic kërkohet nga SNRF 10 'Pasqyra financiare të konsoliduara', por ka përjashtuar Bija shpk nga konsolidimi për shkak se drejtimi nuk ka përcaktuar ende vlerën e drejtë të aktiveve dhe detyrimeve të Bijes në datën e blerjes, sic kërkohet nga SNRF 3 'Kombinimi i biznesit'. Investimi është matur dhe paraqitur me kosto në pasqyrat financiare.

Materialiteti i audituesve i përcaktuar për 31 dhjetor 2022 është 2 mln Leke. Totali i aktiveve në Pasqyrën e pozicionit financiar për 31 dhjetor 2022 janë 125 mln leke ndërsa në 31 dhjetor 2021 janë 150 mln leke. Zëri i filialit për 31 dhjetor 2022 përben 90% të totalit të aktivitetit ndërsa për 31 dhjetor 2021 përben 85% të totalit të aktivitetit.

Kërkohet: Përcaktoni se çfarë lloji opinionit do t'i leshojnë audituesit drejtimin? (2 pike). Përgatisni një ekstrakt ku të përmbajë paragrafin e opinionit (2 pike) dhe bazën për dhënien e opinionit (2 pike).

Përgjigje:

Lloji opinionit që audituesit do t'i leshojnë drejtimin është një opinion i kundërt. (0.5 pike) Kjo për arsye se audituesi ka konstatuar një shmangie nga Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. (0.5 pike) Drejtimi i shoqërisë ka përjashtuar konsolidimin e Bija sh.p.k nga pasqyrat e konsoliduara për vitin financiar që mbyllet më 31 dhjetor 2022. Nga të dhënat e ushtrimit, anomalia e identifikuar është materiale por edhe e përhapur në të gjithë zërat e pasqyrave financiare për arsye se zëri i filialit përben gati 90% të totalit të aktivitetit për 31 dhjetor 2022 dhe 85% respektivisht për 2021. (1 pike)

Ekstrakt i cili përmban paragrafin e opinionit:

Opinionin kundër

Në kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara të shoqërisë tregtare Conglomerate shpk dhe filialeve të saj (Grupi), të cilat përfshijnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2022, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse të konsoliduar, pasqyrën e ndryshimeve në kapital të konsoliduar dhe pasqyrën e flukseve të parasë të konsoliduar për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare të konsoliduara, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme. (1 pike)

Sipas opinionit tonë, për shkak të rëndësisë së çështjes të trajtuar në seksionin e Bazës për Opinionin Kundër të raportit tonë, pasqyrat financiare të konsoliduara bashkëlidhur nuk paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, (ose nuk japin pamjen e vërtetë dhe të drejtë për) pozicionin financiar të shoqërisë me datën 31 Dhjetor 2022, dhe performancën financiare e flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). (1 pike)

Ekstrakt i cili përmban paragrafin e bazës për dhënien e opinionit:

Baza për opinionin e kundërt

Sikurse shpjegohet në shënimin X, Grupi nuk ka konsoliduar filialin Bija shpk, të cilën Grupi e ka blerë gjatë vitit 2022, për shkak se nuk ka qenë në gjendje të përcaktonte vlerat e drejta të disa prej aktiveve dhe detyrimeve materiale të filialit në datën e blerjes. Për këtë arsye, investimi është njohur me kosto. Sipas SNRF-ve shoqëria duhet të kishte konsoliduar filialin e

saj për blerjen, bazuar në shumat provizore. Nëse filiali Bija shpk do të kishte qenë konsoliduar, shumë elemente në pasqyrat financiare të konsoliduara bashkëlidhur do të ndikoheshin materialisht. Efektet në pasqyrat financiare të konsoliduara që lidhen me mos konsolidimin nuk janë përcaktuar. (1 pike)

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit të Përgjegjësisë të Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare (të zbatueshme në juridiksionin përkatës) dhe kemi përmbushur edhe përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. (0.5 pike)

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë kundër. (0.5 pike)

Ushtrimi 5

Ju jeni menaxheri i auditimit të Kiwi & Co dhe ju janë dhënë ekstraktet e pasqyrave financiare dhe informacioni i mëposhtëm në lidhje me klientin tuaj, Strawberry Kitchen Designs Co (Strawberry), i cili është një prodhues kuzhinash. Fundi i vitit të kompanisë është 30 Prill 2021.

Strawberry kohët e fundit ka përjetuar vështirësi tregtare, pasi klienti i saj kryesor, i cili i detyrohet 0.6 milionë dollarë Strawberry-t, ka ndërprerë tregtimin dhe nuk ka gjasa që ndonjë nga këto të merret. Megjithatë, balanca përfshihet në ekstraktet e pasqyrave financiare më poshtë. Drejtori i shitjeve është larguar së fundmi nga Strawberry dhe ende nuk është zëvendësuar.

Fluksi mujor i parasë ka shfaqur një dalje neto monetare për dy muajt e fundit të vitit financiar dhe parashikohet negativ për vitin financiar në vijim. Si rezultat i kësaj, kompania ka qenë e ngadaltë në pagesën e furnitorëve të saj dhe disa po kërcënojnë me veprime ligjore për të rikuperuar shumat që i detyrohen.

Për shkak të vështirësive të saj financiare, Strawberry humbi një shlyerje kredie dhe, si rezultat i kësaj shkeljeje të marrëveshjes të kredisë, banka ka kërkuar që kredia prej 4.8 milion dollarë të shlyhet plotësisht brenda gjashtë muajve. Drejtorët kanë vendosur që për të kursyer cash, nuk do të paguhet dividend për vitin 2021.

Ekstrakte të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 30 prill:

	Drafti	Aktual
	2021	2020
Aktivet afatshkurtra	mln \$	mln \$
Inventari	3.4	1.6
Të arkëtueshmet	1.4	2.2
Mjete monetare dhe ekuivalentët e saj	0	1.2
Detyrimet afatshkurtra		
Llogaritë e pagueshme tregtare	1.9	0.9
Overdraft	0.8	0
Kreditë	4.8	0.2

Kërkohet: Përshkruani procedurat e auditimit që duhet të kryeni për të vlerësuar nëse Strawberry Kitchen Designs Co është një aktivitet në vijimësi.

Përgjigje:

Procedurat e auditimit që duhet të kryeni për të vlerësuar nëse Strawberry Kitchen Designs Co është një aktivitet në vijimësi (cdo procedure e pershkuar sakte 0.5 pike, ne total 6 pike):

1. Merrni parashikimin e fluksit monetar të kompanisë dhe rishikoni flukset hyrëse dhe dalëse të parave. Vlerësoni supozimet për arsyeshmërinë dhe diskutoni gjetjet me menaxhmentin për të kuptuar nëse kompania do të ketë flukse monetare të mjaftueshme.
2. Kryeni një analizë të ndjeshmërisë mbi flukset monetare për të kuptuar marzhin e sigurisë që ka kompania për sa i përket fluksit të saj neto të parave hyrëse/dalëse.
3. Diskutoni me drejtorin financiar nëse drejtori i shitjeve është zëvendësuar dhe nëse është marrë ndonjë klient i ri për të zëvendësuar atë të humbur.
4. Rishikoni librin e shitjeve dhe porosive pas fundit të vitit për të vlerësuar nëse nivelet e tregtisë ka të ngjarë të rriten dhe nëse shifrat e të hyrave në parashikimin e fluksit të parasë janë të arsyeshme.
5. Rishikoni marrëveshjen e huasë dhe rillogaritni kushtet e marrëveshjes që janë shkelur. Konfirmoni kohën dhe shumën e shlyerjes së kredisë.
6. Rishikoni çdo marrëveshje me bankën për të përcaktuar nëse ndonjë marrëveshje tjetër është shkelur, veçanërisht në lidhje me overdraft.
7. Diskutoni me drejtorët nëse ata kanë kontaktuar ndonjë bankë alternative për financim për të vlerësuar nëse kanë ndonjë mjet tjetër për të shlyer kredinë prej 4.8 milionë dollarë.
8. Rishikoni çdo korrespondencë me aksionarët për të vlerësuar nëse ndonjë prej tyre ka të ngjarë të rrisë investimin e tyre në kompani.
9. Rishikoni korrespondencën pas fundit të vitit me furnitorët për të identifikuar nëse ndonjë tjetër ka kërcënuar me veprime ligjore ose ka refuzuar të furnizojë mallra.
10. Kërkoni nga avokatët e Strawberry për ekzistencën e ndonjë procesi gjyqësor shtesë dhe kërkoni vlerësimin e tyre për shumat e mundshme për t'u paguar për furnitorët.
11. Kryeni teste auditimi në lidhje me ngjarjet e mëvonshme për të identifikuar çdo çështje që mund të tregojë rrezikun e mos vijimësisë.
12. Rishikoni procesverbalet e minutave të takimit të bordit pas fundit të vitit për të identifikuar çdo çështje tjetër që mund të tregojë vështirësi të mëtejshme financiare për kompaninë.
13. Rishikoni llogaritë e menaxhimit pas fundit të vitit për të vlerësuar nëse janë në përputhje me parashikimin e fluksit të parasë.
14. Konsideroni nëse baza e vazhdimësisë është e përshtatshme për përgatitjen e pasqyrave financiare.
15. Merrni një letër përfaqësimi me shkrim që konfirmon pikëpamjen e drejtimit se Strawberry do të vijojë në vazhdimësi.

Ushtrimi 6

Shoqeria e Transportit “Fast Delivery” ka një flote me mjete transporti. Ne te shkuaren Shoqeria ka ndjekur politiken e blerjes se te gjitha mjeteve te transportit. Gjate vitit ushtrimor qe eshte duke u audituar Shoqeria vendosi qe mjetet e reja te transportit te merren vetem me qira. Per rrjedhoje metoda e kontabilizimit per mjetet e transportit te reja e aplikuar eshte ajo e parashikuar nga SNRF 16 “Qiraja” duke qene se edhe kuadri kontabel i aplikuar eshte ai i SNRFse. Ky ndryshim ne politiken e Shoqerise eshte shpalosur ne menyre te plote dhe te detajuar ne pasqyrat financiare te fund vitit per vitin ushtrimor.

Kërkohet:

Percaktoni se cfare lloji opinioni do t'i leshojne audituesit drejtimit? **(2 pike)**. Pergatisni nje ekstrakt ku te permbaje paragrafin e opinionit **(2 pike)** dhe shtjelloni dhe shpjegoni arsyet qe keni perdorur ne percaktimin e llojit te opinionit **(2 pike)**.

Pergjigje:

Ne baze te fakteve dhe rrethanave te shpjeguara me lart audituesi ligjor do te duhet te leshoj nje opinion te pamodifikuar drejtimit te Shoqerise "Fast Delivery". Paragrafi i opinionit do te duhet te jete si me poshte:

"Sipas opinionit tone, pasqyrat financiare bashkelidhur paraqesin drejt, ne te gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar te shoqerise me daten 31 Dhjetor 20X1, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF)." (3 pike)

Kontabilizimi i mjeteve te transportit te reja ne pajtim me SNRF 16 eshte trajtimi kontabel qe duhet te aplikoj Shoqeria ne vitin ushtrimor aktual ndersa mjetet e transportit e blera ne ushtrimet e meparshme do duhet te kontabilizohen sipas trajtimit kontabel qe parashikohet nga SNK 16 (3 pike).

Ushtrimi 7

Ekipi i auditimit i Shoqerise se Auditimit "Champion" eshte duke planifikuar strategjine e auditimit per Pasqyrat Financiare per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022 te Shoqerise "Firtz". Pjese e strategjise eshte identifikimi i tepricave te llogarive ose shenimeve qe jane te rëndesishme si dhe pohimet perkatese duke aplikuar modelin e rrezikut te auditimit. Ekipi i auditimit ka aplikuar nje perqasje me tre hapa per te perdorur modelin e rrezikut te auditimit te cilat jane 1) percaktimi i rrezikut te auditimit, 2) vleresimi i rrezikut te anomalive materiale dhe 3) Percaktimi i rrezikut te zbulimit per cdo teprice llogarie te rëndesishme dhe nivelin e pohimeve duke u bazuar ne nivelin e rrezikut te auditimit dhe rrezikut te anomalive materiale.

Si pjese e procesit te planifikimit, ekipi i auditimit e percakton rrezikun e anomalive materiale duke perdorur perqasjen "cfare mund te shkoje keq" ose "WCGW" kur vlereson mbi cdo pohim mbi pasqyrat financiare dhe/ose tepricat e llogarive ose shenimeve.

Kërkohet:

(a) Percaktoni se kush jane teprica e llogarive dhe shenimeve ne pasqyrat financiare qe zakonisht identifikohen si te rëndesishme ne ciklin e njohjes se te ardhurave te nje Shoqerie **(2 pike)** si dhe (b) kush jane pohimet perkatese per secilin nga keto teprica dhe llogari te identifikuara **(2 pike)**. Pergatisni duke listuar ne nje forme tabulare te gjitha (a) tepricat e llogarive dhe shenimeve te rëndesishme ne ciklin e njohjes se te ardhurave dhe (b) pohimeve si dhe (c) te cfare mund te shkoje keq "WCGW" per secilin nga pohimet e identifikuara **(2 pike)**.

Pergjigje: Shtjelluar ne formen tabelare si me poshte:

Tepricat e Llogarive te Rendesishme (Cikli i te ardhurave)	Pohimet Perkatese	Cfare mund te shkoje keq/”WCGW”
Te ardhurat	Ndodhja	Drejtimi mund te mbideklaroje te ardhurat duke shtuar shitje fiktive ose duke fryre shitjet aktuale
	Plotesia	Jo te gjitha shitjet jane rregjistruar
	Paraqitja në periudhën e duhur	Shitjet jane rregjistruar ne periudhen kontabel e gabuar.
Te drejta te arketueshme	Ekzistenca	Te drejta e arketueshme jane te mbideklaruara dhe nuk perfaqesojne shumat per tu arketuar nga shitjet aktuale
	Plotesia	Jo te gjitha te drejta per tu arketuar jane te rregjistruara ne kontabilitet
	Vleresimi	Te drejta e arketueshme nuk jane njohur ne pasqyrat financiare ne shumat e duhuara dhe korrigjime kontabel per zhvleresime jane te nevojitura.
1 Pike	2 Pike	3 Pike

Ushtrimi 8

Ju jeni një Manaxher në një nga Departamentet e Auditimit dhe dhënies së Sigurisë së Lion & Co, një firmë e madhe e Kontabilistëve të Çertifikuar. Aktualisht jeni caktuar në një angazhim “due diligence” për një nga klientët e auditimit të firmës suaj, Cheetah Co, një prodhues i mobiljeve me porosi. Auditimi i Cheetah Co kryhet nga një ekip nga një departament tjetër dhe ju nuk keni qenë kurrë i përfshirë në auditimin e këtij klienti.

Angazhimi është për të kryer një rishikim “due diligence” financiare dhe operacionale të Zebra Co, një kompani e cila është identifikuar si një objektiv potencial për blerje nga Cheetah Co, për shkak të sinergjive të ofruara dhe potencialit për të zgjeruar objektet ekzistuese të prodhimit. Si pjesë e rishikimit “due diligence”, ju është kërkuar të jepni një vlerësim të aktiveve dhe detyrimeve të Zebra Co dhe një analizë të parashikimeve të fitimit operativ të kompanisë. Kjo do të ndihmojë Cheetah Co në përcaktimin e një çmimi të përshtatshëm blerjeje për Zebra Co.

Gjatë punës në terren të angazhimit, ekipi juaj identifikoi dy çështje, të cilat kërkojnë shqyrtimin tuaj të mëtejshëm, si më poshtë:

1. Gjatë shqyrtimit të korrespondencës me klientët në lidhje me të arkëtueshmet e papaguara, një nga anëtarët e ekipit gjeti një letër nga një klient, për të cilin Zebra Co prodhon një numër produktesh unike, duke dhënë njoftim paraprak se ata nuk do të rinovojnë marrëveshjen e tyre të blerjes kur të përfundojë marrëveshja aktuale. Klienti komunikoi se ata po komunikojnë me një furnitor të ri treg, i cili është dukshëm më i lirë se Zebra Co. Një analizë e shkurtër, identifikoi se klienti siguron, mesatarisht, pothuajse 5% të të ardhurave vjetore të Zebra Co.

2. Zebra Co ka në pronësi një copë tokë, e cila i është dhënë si dhuratë nga autoritetet lokale dhjetë vjet më parë. Toka rrethon hyrjen e ambienteve kryesore të prodhimit dhe është caktuar si rezervat natyror. Ka kufizime në përdorimin e tokës, të cilat gjithashtu kufizojnë se kujt pronari mund t'ia shesë tokën në të ardhmen. Toka ka vlerë kontabël zero në pasqyrat financiare.

Asnjë çështje shtesë nuk ka lindur për shqyrtimin tuaj. Ju jeni gjithashtu në dijeni se pasqyrat financiare për dhjetë vitet e fundit janë audituar dhe nuk janë bërë modifikime në opinionin e audituesit gjatë kësaj periudhe.

Kërkohet:

Në lidhje me dy çështjet e identifikuara më sipër, rekomandoni cilat procedura duhet të kryhen.

Pergjigje:

Procedurat që duhet të kryhen për secilën nga çështjet e mësipërme:

1. Zgjidhja e kontratës (3.5 pikë, 0.5 pikë për secilën nga procedurat e mëposhtme)

Rishikoni në mënyrë analitike vlerën totale historike të të ardhurave nga klienti për të ndihmuar në përcaktimin e një vlerësimi të përshtatshëm për humbjen e mundshme të të ardhurave të ardhshme dhe flukseve monetare hyrëse. **(0.5 pikë)**

Pyetni drejtimin nëse humbja e klientit do të ketë pasoja të tjera, të tilla si shitja e aktiveve specifike ose pushimi nga puna i stafit dhe kostot që lidhen me këtë nëse kërkohet një veprim i tillë. **(0.5 pikë)**

Kryeni një rishikim analitik për të identifikuar klientët e tjerë kryesorë sipas vlerës së kontributeve të të ardhurave në biznes. Për të gjithë klientët kryesorë të identifikuar, rishikoni çdo marrëveshje/kontratë furnizimi në fuqi për të përcaktuar se kur përfundojnë. **(0.5 pikë)**

Nëse ndonjë kontratë me klientët kryesorë do të përfundojë brenda disa viteve të ardhshme, pyesni drejtimin nëse ka pasur ndonjë diskutim me këta klientë në lidhje me rinegocimin e kushteve. **(0.5 pikë)**

Merrni çdo korrespondencë të disponueshme me klientët kryesorë të identifikuar për të identifikuar nëse ka ndonjë tregues që ata mund të përpiqen ose të rinegociojnë kushtet e marrëveshjeve të tyre ose t'i kalojnë ato në një furnizues të ri. **(0.5 pikë)**

Pyetni një menaxher përkatës, si një menaxher prodhimi ose menaxher shitjesh, nëse ka ndonjë inventar specifik që është prodhuar në lidhje me klientin që nuk po rinovon marrëveshjen. Nëse është kështu, merrni një përmbledhje të stoqeve totale të prodhuara për këtë klient dhe diskutoni me drejtimin nëse ata do të jenë në gjendje ta shesin këtë inventar me çmimin e plotë duke marrë parasysh njoftimin për zgjidhjen e kontratës. **(0.5 pikë)**

Inspektoni parashikimet e përgatitura nga drejtimi për të siguruar që ndryshimet në të ardhurat dhe kostot e identifikuara më sipër janë përfshirë siç duhet. **(0.5 pikë)**

2. Toka e dhuruar (2.5 pikë, 0.5 pikë për secilën nga procedurat e mëposhtme)

Rishikoni kushtet e specifikuara kur toka iu dha fillimisht Zebra Co. Identifikoni kufizimet specifike në lidhje me mënyrën se si mund të përdoret toka dhe kujt mund t'i shitet toka në të ardhmen. **(0.5 pikë)**

Pyesni një këshilltar ligjor nëse kjo do të ketë ndonjë ndikim në lidhje me shitjen e tokës Cheetah Co dhe përdorimin e saj. **(0.5 pikë)**

Angazhoni një ekspert të vlerësimit të tokës për të ofruar një vlerësim të tokës. Kërkojini atij të marrë në konsideratë implikimet e kufizimeve të vendosura mbi tokën në vlerësim. **(0.5 pikë)**

Nëse Zebra Co nuk lejohet të shesë tokën, ose kufizimet e vendosura në përdorimin e tokës janë shumë kufizuese, kërkoni këshillim ligjor në lidhje me opsionet e mundshme, duke përfshirë nëse toka mund t'i dhurohet autoritetit lokal përpara blerjes. **(0.5 pikë)**

Inspektoni parashikimet e përgatitura nga drejtimi i Zebra Co për të identifikuar kostot dhe të ardhurat specifike të parashikuara që lidhen me përdorimin e tokës. Përgatitni një version të rishikuar të parashikimeve që përjashton këto të ardhura dhe kosto për të identifikuar implikimet e mundshme në parashikime nëse marrëveshja kryhet duke përjashtuar tokën e dhuruar. **(0.5 pikë)**